



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS SUHAREKË

Numri i lëndës: 2021:249696
Datë: 20.07.2022
Numri i dokumentit: 03249399

C.nr.1128/2021

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN – DEGA NË SUHAREKË, me gjyqtarin Robert Tunaj dhe bashkëpunëtorin profesional Feim Bytyqi, në çështjen kontestimore të paditëses E. B. nga Prizreni rruga “F.” nr.... të cilën e përfaqëson i autorizuari i saj Av.R. G. nga Suhareka kundër të paditurës Komuna e Suharekës – Drejtoria Komunale e Arsimit të cilën e përfaqëson A. B. me aktemërim, me padi për shkak të ndërprerjes së marrdhënies së punës, në seancën e shqyrtimit kryesor të mbajtur me datë 07.07.2022 në prani të te autorizuarit të paditëses dhe të përfaqësuesit të te paditurës, dhe fjalës përfundimtare me shkrim të datës 13.07.2022 me datë 20.07.2022 mori dhe përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I.APROVOHET në tërësi si e bazuar kërkesëpadija e paditëses E. B. nga Prizreni rruga “F.” nr.....

II.DETYROHET e paditura Komuna e Suharekës – Drejtoria Komunale e Arsimit që paditëses E. B. t’ia kompensoj pagat e papaguara për periudhën 01.10.2018 deri me 31.08.2020 në shumë të përgjithshme **6720.29** (gjashtëmijë e shtatëqind e njëzetë euro njëzetë e nëntë cent) dhe atë të specifikuara:

- në emër të pagave neto shumë prej **5707,21** euro;
- në emër të trustit pensional shumë prej **640,06** euro dhe
- në emër të tatimit në paga shumë prej **373,02** euro,

të gjitha këto me kamatë ligjore sipas mjeteve të deponuara në bankat afariste mbi një vit pa destinim të caktuar duke e llogaritur nga data e parashtrimit të padisë 20.10.2018 e deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përbarimit të dhunshëm.

III.OBLIGOHET e paditura që paditëses t’ia kompensoj shpenzimet e procedurës gjyqësore në shumë e përgjithshme prej 1105 (njëmijë e njëqind e pesë) euro, në afatit të paraparë si në pikën II të këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Paditësja E. B. nga Prizreni rruga “F.” nr...., përmes të autorizuarit të saj Av.R. G. nga Suhareka, pranë kësaj gjykate me datë 26.10.2018 ka parashtruar padinë me kërkesëpadi për

shkak të ndërprerjes së marrëdhënies së punës ndaj të paditurës Komuna e Suharekës – Drejtoria Komunale e Arsimit, me të cilën ka kërkuar që paditësja të sistemohet në vendin e punës në përputhje me përgatitjen e saj profesionale .

E paditura përmes përgjigjes në padi me datë 31.10.2018 e ka kundërshtuar në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë në parim si të pabazuar dhe ka propozuar që padia dhe kërkesëpadia e paditëses të hudhet poshtë si e pa bazuar.

Gjykata lidhur me kërkesëpadinë kishte vendosur me Aktgjykimin C.nr.574/2018 i cili aktgjykim me Aktvendimin e Gjykatës ës Apelit Ac.nr.126/19 është prishur dhe qështja është kthyer në rigjykim.

Gjykata në riprocedurë të kësaj çështje ka mbajtur seancën gjyqësore me datë 26.04.2022, në të cilën i autorizuari i paditëses Av.R. G. ka deklaruar se paditësja ka qenë e punësuar si profesoreshë e fizikës në QAMO “J. e R.” në Suharekë nga data 01.09.2010 deri me dt.02.10.2014, me dt.02.10.2014 është zgjedhur drejtoreshë në SHFMU “F. i A.” në R. të cilin vend ka qenë deri me dt.03.10.2018, me dt.04.10.2018 i është ndërprerë marrëdhënia e punës dhe nuk është sistemuar në asnjë vend pune përkundër ankesave të shumëta dhe pranimit nga ana e Komunes, nga ana e komisionit për parashtrësia dhe ankesa se e njëjta duhet të sistemohet në vendin e punës sipas udhëzimit administrativ nr.08-2014.

Me dt.08.07.2019 Drejtoria e Arsimit e ka sistemuar në punë në SHFMU “R. B.” në B. me 10 orë mësimi, pastaj me kontratën tjetër të dt.06.01.2020 me 18 orë mësimi dhe në fund me kontratën e dt.01.09.2020 me 20 orë mësimi. Më tej i autorizuari i paditëses ka bërë **precizimin e kërkesëpadisë dhe ka theksuar se kemi të bëjmë me padi për kompensimin e pagave të papaguara** ku ka kërkuar kompensimin e 9 pagave nga dt.01.10.2018 deri me dt.30.06.2019, kompensimin për 6 paga në shumën prej 50 % nga dt.01.07.2019 deri me dt.31.12.2019 kur paditësja ka punuar me normë jo të plotë prej 10 orësh dhe kompensimin për 8 muaj diferencën në pagë në orë pune ku ka punuar me 18 orë deri te norma e plotë prej 20 orësh. Pasi që qështja e sistemimit me orarë të plotë është zgjidhur ka kërkuar vetëm kompensimin e për pagat e pa realizuara . Në në fjalën përfundimtare të paraqitur me shkrim me dt.13.07.2022 ka bërë precizimin e padisë dhe kërkesëpadisë për kompensimin e pagave të papaguara dhe diferencat në paga si vion : paga neto që duhet ti paguhet paditëses është 5.707,21 €, obligimet ndaj trustit pensional në shume prej 640,06 € dhe tatimi në paga ne shumë prej 373,02 €. Njëherit ka kërkuar shpenzimet gjyqësore në shumë të përgjithshme prej 1105 euro dhe atë 104 euro për përpilimin e padisë, 41 euro për taksën gjyqësore, 675 euro shpenzime të përfaqësimit për 5 seanca, 104 euro për përpilimin e ankesës, 31 euro në emër të taksës për ankesë dhe 150 euro për ekspertizën financiare.

Përfaqësuesi i të paditurës A. B. në seancën e shqyrtimit kryesor ka kundërshtuar pretendimet e paditësit me kërkesë që kërkesëpadia te refuzohet në tersi si e pa bazë, ndërsa ne fjalën përfundimtarë te dorëzuar me shkrim ka pretenduar se paditësja ka qenë në marrëdhënie pune në Gjinnazin “J. e R.” sipas kontratës nr.10/2015 të dt.01.09.2010, kjo kontratë ka qenë e afatizuar në kohë, e njëjta ka vazhduar edhe më tej pa asnjë lloj pengese procesin e punës si mësimdhënëse deri në emërimin e saj në pozitën e Drejtorit të shkollës “F. i A.” në R.. Me rastin e emërimit të saj në pozitën e Drejtorit statusi ndryshon dhe e njëjta në bazë të dispozitave ligjore në fuqi trajtohet me ligjin e shërbimit civil të Kosovës. E njëjta pas marrjes së detyrës së Drejtorit të shkollës nuk ka pezulluar marrëdhënien e punës ku me këtë rast ka bërë shkoputje të njëanshme të mësimdhënëses sipas kontratës së vitit 2014, emërimi në pozitën e Drejtorit ka qenë me mandat 4 vjeçar që nënkupton që pas përfundimit të kësaj kontrate ka pushu obligimi i palëve kontraktuale në këtë kontest.

Gjykata për vlerësimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike në këtë çështje juridike në procedurën e provave nga shqyrtimi i mbajtur në këtë gjykatë me datë 07.07.2022, bëri administrimin e provave dhe atë bëri leximin e: vërtetimit nr.205/18 të dt.18.10.2018 të lëshuar nga shkolla e mesme teknike “S. L.” në Suharekë, vërtetimit nr.48 të dt.23.10.2018 të lëshuar nga SHFMU “F. i A.” në R., aktvendimit për ndërprerjen e marrdhënies së punës nr.01-118-624-87 dt.26.09.2018, vendimit të komisionit për ankesa nr.01/181-48655 dt.12.10.2018, përgjigjes nr.05/1014 të dt.16.10.2018, kërkesës 01/181/67973 të dt.23.10.2018, diplomës nr.222 dt.30.04.2010, vendimit 01.nr.16-6599 dt.19.09.2014, kontratës së punës 01.nr.16-6600 dt.19.09.2014, kontratës së punës për mësimdhënës 05.nr.597 dt.01.09.2011, vendimit A.nr.638/2018 të KPMSHC-së, ankesën 01/036/64634, vendimit të inspeksionit të punës nr.47/2019 dt.13.02.2019, vendimit nr.265/19 dt.02.05.2019, kontratës së punës nr.37/2020 dt.04.09.2020, aktvendimit 05.nr.740 dt.08.07.2019 dhe ekspertizës financiare të dt.04.05.2022 të punuar nga eksperti financiar G. S..

Gjykata pas vlerësimit të provave materiale, deklarimeve të palëve ndërgjyqëse dhe administrimit të provave të lartcekura në kuptim të nenit 7 dhe 8 të Ligjit Për Procedurën Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar dhe vlerësuar çdo provë veç e veç dhe të gjithat së bashku dhe ka gjetur se:

Kërkesëpadia e paditëses është e bazuar.

Me shikimin dhe leximin në vërtetimin nr.205/18 të dt.18.10.2018 të lëshuar nga shkolla e mesme teknike “S. L.” në Suharekë u vërtetua se paditësja ka qenë mësimdhënëse e lëndës së fizikës (plotësim norme) në SMT “S. L.” – Suharekë në vitin shkollor 2015/16 – 10 orë mësimore, 2016/17 – 8 orë mësimore dhe 2017/18 – 10 orë mësimore, ndërsa nga vërtetimi nr.48 të dt.23.10.2018 të lëshuar nga SHFMU “F. i A.” në R. u vërtetua se paditësja ka filluar të punoj në SHMU “F. i A.” në R. nga data 02.10.2014 deri me datë 04.10.2018 në cilësinë e drejtoreshës së shkollës.

Me aktvendimin për ndërprerjen e marrdhënies së punës nr.01-118-624-87 dt.26.09.2018 të lëshuar nga Kryetari i Komunës së Suharekës u vërtetua se paditësja i është ndërprerë marrdhënia e punës për shkak të skadimit të kontratës së punës me datë 21.09.2018, e që ky vendim edhe është kontestuar nga paditësja si i pa bazë pasi që e paditura sipas paditëses ka pas obligim ligjor t’ia ruaj vendin e punës në momentin e përfundimit të mandatit të drejtorit të shkollës, për qka edhe ka ushtruar ankesë komisionit të ankesave në Komunë. Nga leximi i vendimit të komisionit për ankesa nr.01/181-48655 dt.12.10.2018 të Komunës së Suharekës u vërtetua se është aprovuar ankesa e paditëses e ushtruar kundër aktvendimit për ndërprerjen e marrdhënies së punës ku është precizuar se të lartpërmendurës duhet t’i mundësohet realizimi i kërkesës sipas nenit 9 të udhëzimit administrativ nr.8/2004 dhe me këtë çështje duhet të merret DKA-ja. Me leximin e përgjigjes nr.05/1014 të dt.16.10.2018 të lëshuar nga Drejtoria Komunale e Arsimit të Komunës së Suharekës u vërtetua se DKA-ja e ka njoftuar paditësen se po bënë përpjekje sistematike për t’a sistemuar të njëjtën në procesin e mësimdhënies konform përgatitjes profesionale.

Me kërkesën 01/181/67973 të dt.23.10.2018 të parashtruar DKA-së nga paditësja, u vërtetua se paditësja ka kërkuar na DKA e Komunës së Suharekës që të zbatohet vendimi i komisionit për ankesa nr.01/181/48655 dt.12.10.2018, ndërsa nga shikimi i diplomës nr.222 dt.30.04.2010 u konstatua se paditësja është e diplomuar pranë Fakultetit të Edukimit në Prishtinë në programin kimi fizikë dhe është e kualifikuar Baçelor i kimit – fizikës.

Me vendimin 01.nr.16-6599 dt.19.09.2014 u vërtetua se paditësja ka themeluar marrdhënie të punës Drejtoreshë e SHFMU “F. i A.” në R. duke filluar punën nga data 22.09.2014 për periudhën kohore të kontratës që zgjat 4 (katër) vjet, nga leximi i kontratës së punës 01.nr.16-6600 dt.19.09.2014 u konstatua se e njëjta ka lidh kontratë për kohë të caktuar në vendin e punës Drejtoreshë e SHFMU “F. i A.” në R. për periudhën e caktuar kohore 4 vjet.

Me kontratën së punës për mësimdhënës 05.nr.597 dt.01.09.2011 u vërtetua se paditësja ka themeluar marrdhënie të punësimit si mësimdhënëse në Gjinnazin “J. e R.” në Suharekë me 40 orë punë në javë dhe me 20 orë mësimi në javë për periudhën kohore prej 01.09.2011 e deri me datë 31.08.2012.

Me vendimin A.nr.638/2018 dt.20.11.2018 të Këshillit të Pavarur Mbikqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës u vërtetua se është aprovuar ankesa e paditëses me numër A.nr.638/2018 dt.09.10.2018 dhe është shuqizuar njoftimi me nr.01/016/57232 dt.19.09.2018 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Suharekës, është anuluar konkursi i dt.05.06.2018 për pozitën Drejtor i SHFMU “F. i A.” dhe të gjitha vendimet që rrjedhin nga kjo procedurë si dhe është obliguar Komuna e Suharekës për zbatimin e këtij vendimi në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të vendimit.

Me vendim të inspeksionit të punës nr.47/2019 dt.13.02.2019 u konstatua se është aprovuar ankesa e parashtruar nga paditësja për shkak të ndërprerjes së marrdhënies së punës në Gjinnazin “J. e R.” në Suharekë si e bazuar, ndërsa me leximin e vendimit nr.265/19 dt.02.05.2019 të Inspeksionit të punës si shkallë e dytë u konstatua se është refuzuar ankesa e të paditurës lidhur me vendimin e shkallës së parë dhe është vërtetuar vendimi i inspeksionit të punës nr.47/2019 dt.13.02.2019.

Nga kontrata së punës nr.37/2020 dt.04.09.2020 u vërtetua se paditësja është sistemuar në punë dhe në vendin e punës mësimdhënëse në SHFMU “I. J.-K.” në fshatin J. me normë 20 orë mësimi në javë, me leximin e aktvendimit 05.nr.740 dt.08.07.2019 u konstatua se paditësja është caktuar mësimdhënëse në lëndën e fizikës në SHFMU “R. B.” në fshatin B. me normë 10 orë mësimi për kohë të caktuar.

Me ekspertizën financiare të dt.04.05.2022 të punuar nga eksperti financiar G. S. të cilën eksperti e ka elaboruar edhe në shqyrtim gjyqësor u vërtetua se paditësja nga korriku 2019 deri në dhjetor 2019 ka realizuar të ardhura mujore më të ulëta nga sa do të realizonte sikur të punonte me normë të plotë sipas kontratës me nr.179/2019 dt.30.08.2019 e poashtu ka vazhduar të punoj me normë jo të plotë edhe nga janari 2020 deri në gusht 2020 sipas kontratës me nr.1 dt.06.01.2020. Eksperti në mënyrë të detajuar e ka pasqyruar me tabelat përkatëse në ekspertizë diferencën e pagave mujore në bruto paga, trust pensional, tatim në pagë dhe paga neto dhe ka ardhur në përfundim se paditësja ka mbet pa realizuar gjithsejt paga neto në shumë prej 5707,21 euro, trust pensional në shumë prej 640,06 euro dhe tatim në paga në shumë prej 373,02 euro.

Nga provat e administruara më lart dhe faktet e vërtetuara gjykata ka konstatuar këtë gjendje faktike:

Nuk është kontestuese se paditësja ka punuar si drejtoresh shkollë në periudhën 2014 – 2018 si dhe faktin se me të përfunduar mandati i drejtoreshës se shkollës paditëses i është ndërprere marrdhënja e punës, por kontestuese mes palëve ndër gjyqëse është ndërprerja e marrdhënies së punës dhe sistemimi i paditëses në punë me normë jo të plotë si dhe pagesa e diferencës lidhur me normën e plotë të punës që nuk e ka realizuar paditësja.

Gjykata pas administrimit të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ekspertizës së ekspertit financiar të hartuar me shkrim dhe dëgjimit të ekspertit financiar në shqyrtim gjyqësor, vendosi që të aprovoj padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses si të bazuar, duke ia falur besimin e plotë ekspertizës financiare të dt. 04.05.2022 ku ndër të tjera është konstatuar se paditësja nga korriku 2019 deri në dhjetor 2019 ka realizuar të ardhura mujore më të ulëta nga sa do të realizonte sikur të punonte me normë të plotë sipas kontratës me nr.179/2019 dt.30.08.2019 e po ashtu ka vazhduar të punoj me normë jo të plotë edhe nga janari 2020 deri në gusht 2020 sipas kontratës me nr.1 dt.06.01.2020. Se paditëses i është ndërprerë marrëdhënia e punësimit në mënyrë të kundërligjshme, u vërtetua nga leximi i vendimit të inspeksionit të punës nr.47/2019 dt.13.02.2019 me të cilin është aprovuar ankesa e paditëse dhe nga leximi i vendimit nr.265/19 dt.02.05.2019 të Inspeksionit të punës si shkallë e dytë me të cilin është refuzuar ankesa e të paditurës lidhur me vendimin e shkallës së parë dhe është vërtetuar vendimi i inspeksionit të punës nr.47/2019 dt.13.02.2019. fakti se paditësja është sistemuar në punë me normë jo të plotë u vërtetua nga leximi i kontratës së punës nr.37/2020 dt.04.09.2020 dhe i aktvendimit 05.nr.740 dt.08.07.2019 sipas të cilit e njëjta është caktuar mësimdhënëse në lëndën e fizikës në SHFMU “R. B.” në fshatin B. me normë 10 orë mësimi për kohë të caktuar. Faktin se paditësja ka mbetur pa realizuar diferencën e pagave mujore në bruto paga, trust pensional, tatim në pagë dhe paga neto gjithsej paga neto në shumë prej 5707,21 euro, trust pensional në shumë prej 640,06 euro dhe tatim në paga në shumë prej 373,02 euro, gjykata e vërtetoi në bazë të ekspertizës financiare të cituar më lart.

Faktet si më lart gjykata i vërtetoi edhe nga deklaratimet e të autorizuarit të paditëses dhe të përfaqësuesit të të paditurës të dhëna në shqyrtim gjyqësor të cilët kanë konfirmuar se paditësja ka qenë në marrëdhënie të punës në Gjimnazin “J. e R.” në Suharekë dhe më pas është emëruar drejtoresh në SHFMU “F. i A.” në R. e që pas përfundimit të mandatit katër vjeçar si drejtoresh të njëjtës i është ndërprerë marrëdhënia e punësimit ku më pas është sistemuar në punë si mësimdhënëse me normë jo të plotë siç u cek më lart.

Andaj këtyre provave të administruara gjykata ia fali plotësisht besimin, pasi që për gjykatën janë bindëse dhe vërtetojnë në tërësi se e paditura ia ka ndërprerë marrëdhënien e punës paditëses dhe më pas e ka sistemuar të njëjtën në punë me normë jo të plotë duke i pamundësuar realizimin e plotë të normës me çka ka ardh deri te mos realizimi i diferencës në paga, tatim në pagë dhe trust pensional të përshkruar më për së afërmi si në ekspertizën e ekspertit financiar.

Përfundimisht gjykata konsideron se janë plotësuar të gjitha prezumimet për pagesën e pagave të papaguara për periudhën 01.10.2018 deri me 31.08.2020 dhe për të paditurën lind detyrimi i kthimit, përkatësisht i shpërblimit të vlerës së diferencës saj në të holla bazuar në nenin 9 të Udhëzimit Administrativ të MASHT-it 08/2014.

Vendimi mbi aprovimin e kërkesëpadisë është mbështetur në nenin 9 të Udhëzimit Administrativ nr. 08/2014 të Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë ku në mënyrë shprehimore thuhet *“kandidateve të cilëve u ka përfunduar ose u është ndërprerë mandati i drejtorit / zëvendës drejtorit në institucionet edukativo arsimore, të cilët në këto mandate kanë ardhur nga institucionet edukativo arsimore u ruhet vendi i punës në këto institucione”*. Në këtë rast paditësja ka pasur kontratë pune të paditura që nga dt. 01.09.2010, e deri në momentin kur është zgjedhë drejtor shkolle, e që sipas Udhëzimit Administrativ 10/2015 për kontratën e punës për mësimdhënës të arsimit para universitar neni 3 par. 1 pika 1.1 shprehimisht parashihet se *“të drejtë kontrate në kohë të pa caktuar kanë mësimdhënësi të cilët kanë me shume se një vit pune në arsim”*.

Pretendimet e të paditurës se ndërprerja e mardhenjes se punës ka ardhë si rezultat i asaj se paditësja nuk ka parashtruar kërkesë për pezullimin e mardhenjes së punës gjykata e vlerësoi si tërësisht të pa bazë, pasi që një detyrim i tillë për paditësen as që nuk ka ekzistuar, e gjithashtu është i pa qendrushëm edhe konstatimi se ndërprerja e punës ka ardhur si rezultat i skadimit të afatit të kontratës përkatësisht sipas fuqisë ligjore nenit 67 të Ligjit të punës, pasi që në rastin konkret një dispozitë e tillë nuk është e zbatueshme, paditësja nuk ka kërkuar zgjatjen e mandatit të drejtorit por sistemimin në vendin e punës pas përfundimit të mandatit të punës e që kjo qeshtje rregullohet me udhëzimet administrative 9/14 respektivisht 10/15 të MASHT-it

Vendimin mbi shpenzimet procedurale, gjykata e mbështeti në nenin 452 par.1 të LPK-së

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, e konform nenit 143 të LPK.

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN-DEGA NË SUHAREKË,
C.nr.1128/2021 dt.20.07.2022**

Bashk.Profesional
Feim Bytyqi

Gjyqtari
Robert Tunaj

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 7 ditëve pas marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.